

DITËT E KUJTESËS 2016

Kujtesa si mision

24-28 Tetor 2016, Tiranë

Gjuhët

Anglisht, Shqip, Gjermanisht

Vendi

Hotel Rogner

Telekom Community Store/ish-Blloku

Xheko Imperial Carlsberg

Kontakt

+35569 2687226, karcenaj.matilda@idmc.al, office@idmc.al

Twitter: #MEMORYDAYS2016 | www.idmc.al | www.kas.de/albanien

Organizatorë

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pll. Edil-Alit
Kati 2, Zyra 213/1, Tiranë, Albania
www.idmc.al

Fondacioni Konrad-Adenauer në Shqipëri

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake 1,
Kati 11, Zyra A3, Tiranë, Albania
info.tirana@kas.de

Partnerë Kryesorë: Prezenca e OSBE në Shqipëri / Fondacioni Federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore / Tetori Gjerman / Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë / Ministria e Arsimit dhe Sporteve / Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri

Partnerë të tjerë: Rrjeti Europian i Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS) / IICCMR Bukuresht / Platforma e Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane, Republika Çeke / EUROCLIO (Shoqata Europiane e Mësuesve të Historisë) / Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Kosova / Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Bosnia dhe Hercegovina/ Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit / Instituti për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë/ Shoqata e ish të Përndjekurve Politik Demokrat të Shqipërisë / Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë / Shoqata e ish të Përndjekurve Politikë me qendër në Shkodër / Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës në Shkodër / Instituti Shqiptar i Studimeve Politike / Shoqata "Muzeu Musine Kokalari" / Instituti për Zhvillimin e Arsimit / Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut / Shoqata "Drejtësi dhe Paqe" / ARCT Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për Traumën dhe Torturën

Vendi dhe datat

DITËT E KUJTESËS do të mbahet në Tiranë, Hotel Rogner (24, 25, 26 Tetor), Telekom Community Store/ish-Blloku (27 Tetor), Xheko Imperial Carlsberg (28 Tetor).



PËRMBAJTJA

Përshëndetje nga organizatorët	4
Programi	5
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve	9
Ceremonia e hapjes dhe aktivitetet shoqëruese	9
Prezantimi i ekspozitës “Lufta e Ftohtë”	9
Dokumentari “Fëmijët e Diktaturës”	9
Fjalimi kryesor “Perspektiva Shqiptare si Pjesë e Kujtesës Europiane”	10
Konferenca ndërkombëtare mbi kurrikulën	11
Diskutim në panel mbi brezin e ri dhe qasjen e tij ndaj diktaturës	11
Prezantimi i projekteve të shkollave	12
Prezantimi i institucioneve në fushën e kujtesës	13
Lexime nga autobiografitë e dëshmitarëve të kohës	13
Konkursi “PYET GJYSHËRIT” – Ceremonia e çmimeve	14
Aktiviteti “Hapja e dosjeve të <i>Sigurimit</i> ”	15
Informacione mbi ekspozitat gjatë aktivitetit	16
Shtojcë	17
Prezantimi i institucioneve pjesëmarrësve	17
Lista e pjesëmarrësve	29
Shënime	31



Të nderuar pjesëmarrës,

në emër të organizatorëve të DITËVE TË KUJTESËS, Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) dhe Fondacionit Konrad Adenauer (KAS) ju përshëndesim përzemërsisht në këtë aktivitet që zhvillohet për herë të parë në Tiranë në datat **24-28 Tetor 2016**, nën moton “Kujtesa si mision“.

Gjatë kësaj jave institucione kombëtare dhe ndërkombëtare përfaqësuar nga 60 ekspertë nga Shqipëria, Gjermania, Polonia, Rumania, Çekia, Lituania, Bosnja & Hercegovina dhe Kosova do të prezantojnë para publikut të gjerë punën dhe projektet e tyre në fushën e kujtesës.

Java e kujtesës do të fokusohet në tre fusha kryesore: Ndërtimi i një axhende të përbashkët të aktorëve të ndryshëm që merren me memorien; rishikimi i kurrikulës mësimore në lidhje me periudhën e diktaturës; dhe së treti, ndërgjegjësimi i të rinjve mbi të shkuarën përmes debateve dhe projekteve kreative.

Në faqet e mëtejshme do të gjeni informacionet e zgjeruara mbi aktivitetet e javës së kujtesës si dhe mbi aktorët pjesëmarrës. Në mënyrë që të mund të fiksoni mendimet dhe idetë që mund t’ju lindin gjatë aktivitetit, në fund teksti është pajisur me disa faqe të lira.

Bashkangjitur do të gjeni një formular për vlerësimin e aktivitetit dhe organizimin e tij në përgjithësi. Ju lutem na e dorëzoni atë të plotësuar deri në fund të aktivitetit. Vlerësimi juaj do të na shërbente për ta përmirësuar projektin tonë në vitet në vazhdim.

Aktiviteti DITËT E KUJTESËS zhvillohet në kuadër të Tetorit Gjerman, në bashkëpunim me OSBE, Fondacionin federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore, Ministrinë e Arsimit dhe partnerë të tjerë brenda dhe jashtë vendit.

Ju urojmë DITË KUJTESE të mbara dhe jemi të gatshëm t’ju ndihmojmë për çdo pyetje apo sqarim që mund t’ju nevojtet.

Jonila Godole
Drejtoreshë e IDMC

Walter Glos
Drejtor i KAS

PROGRAMI
24-28 Tetor, Tiranë

E hënë 24 Tetor 2016, Salla Antigonea / Rogner Hotel TE KUJTOSH APO TË HARROSH TË SHKUARËN	
17:30	Regjistrimi
18:00 – 18:20	Fjala hapëse nga organizatorët: Jonila Godole , Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) dhe Walter Glos , Fondacioni Konrad Adenauer (KAS). Përshëndetje nga Romana Vlahutin , Ambasadore e Bashkimit European në Shqipëri; Anke Holstein , Zëvendësambasadore e Gjermanisë.
18:20 – 18:30	Prezantimi i ekspozitës “Lufta e Ftohtë” nga Ulrich Mähler , Fondacioni Federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore
18:30 – 18:45	Fjalimi kryesor nga Agron Gjekmarkaj , Universiteti i Tiranës « Perspektiva Shqiptare si Pjesë e Kujtesës Europiane »
18:45 – 19:30	Shfaqje dokumentari “ Fëmijët e Diktaturës ” regjia nga Besnik Bisha , Universiteti i Arteve.
19:30	Koktej
E martë 25 Tetor, Salla Antigonea / Rogner Hotel KONFERENCA NDËRKOMBËTARE: BALLAFAQIMI ME TË SHKUARËN PËRMES KURRIKULËS	
8:30	Regjistrimi
9:00 – 9:30	Seancë Plenare Moderatore: Jonila Godole, IDMC Nora Malaj , Zëvendësministre e Arsimit dhe e Sportit Genc Pollo , Kryetar i Komisionit Parlamentar të Medias dhe Arsimit Valentina Duka , Historiane, Dekane e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë Romeo Gurakuqi , Historian, Universiteti European i Tiranës
9:30 - 10:30	Paneli I: Zhvillimi i Kurrikulës pas 1990ës – Probleme dhe Sfida Moderatore: Elsa Ballauri, Drejtore e Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut Ulrich Mähler , Fondacioni Federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore Gerti Janaqi , Drejtor i Institutit për Zhvillimin e Arsimit, Tiranë Radu Preda , President i ICCMER, Bukuresht Vytene Muschick , Eksperte për kurrikulën dhe programet edukative, Lituani
10:30 – 11:00	Pushim kafeje
11:00 - 12:15	Paneli II: Histori e Aplikuar në Europën Lindore Moderatore: Eva Tafili Hyskaj, Universiteti i Tiranës

	<p>Neela Winkelmann, Drejtore e Platformës Kujtesa dhe Ndërgjegja Europiane, Pragë</p> <p>Vincent Lungwitz, Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Prishtinë</p> <p>Kinga Hartmann-Wóycicka, Koordinatorë e Projekteve Gjermano-Polake, Görlitz</p> <p>Karolina Dzielak, Rrjeti Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS), Varshavë</p>
12:15 - 13:00	<p>Paneli III: Histori e Aplikuar në Shqipëri dhe Rajon Moderatore: Gentiana Kera, Universiteti i Tiranës</p> <p>Luljeta Lleshanaku, Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë</p> <p>Enriketa Papa, Universiteti i Tiranës</p> <p>Adis Hukanović, Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Sarajevë</p> <p>Fatmiroshe Xhemalaj, Ambasadore e Shoqatës Europiane të Mësuesve të Historisë (Euroclio) në Shqipëri</p> <p>Bilal Kola, Instituti për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë, Tiranë</p>
13:00 – 13:30	Diskutime dhe përfundime
13:30 – 14:30	Drekë në Hotel Rogner
15:00 – 16:30	<p>Prezantime I: Projekte dhe Iniciativa të Shkollave mbi Diktaturën Moderatore: Enriketa Papa, Universiteti i Tiranës</p> <p>«#throwback», Kolegji “New York”, Tirana</p> <p>«Kundër Besimit Katolik në Mirditë», Gjimnazi i Rrëshenit</p> <p>«Vendet e Kujtesës – Burgu i Spaçit », Viti I, Master, Departamenti i Historisë</p> <p>«Jeta e përditshme në regjimin komunist», Gjimnazi Sami Frashëri, Tiranë</p> <p>«Kupto të shkuarën përmes fotografive familjare», Gjimnazi Isa Boletini, Vorë</p> <p>«Kërkimi në gazetatat komuniste: Procese, rezultate dhe hapje dialogu», OTTONomy</p> <p>«Viktimat e diktaturës», Gjimnazi Çajupi, Tiranë</p> <p>«Studimi: Sindroma e traumës post-komuniste», Trudy Anderson</p>
17:00 – 18:30	<p>dhe Diktatura Shqiptare* la, Gazetar, RTSH</p> <p>Nevila Nika, Universiteti European i Tiranës tor i Institutit Shqiptar të Studimeve Politike, Tiranë t i RTSH & OSBE</p>
<p>E mërkurë 26 Tetor, Salla Tirana, Rogner Hotel</p> <p>KUJTESA SI MISION</p>	
8:30	Regjistrimi
9:00 – 10:30	<p>Prezantime II: Projekte dhe Iniciativa në Fushën e Kujtesës oderatore: Elira Çanga, Prezenca e OSBE në Shqipëri</p> <p>Pjerin Mirdita, “Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës”, Shkodër</p> <p>Migen Qiraxhi, Instituti i Studimeve Politike, Tiranë</p>

	<p>Nehari Sharri, Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Prishtinë Rrapo Zguri & Valbona Bezati, “Observatori Shqiptar i Kujtesës”, IDMC Uran Butka, Drejtor i Institutit të Studimeve shqiptare “Lumo Skëndo” Luigj Mila, Organizata “Drejtësi dhe Paqe”, Shkodër</p>
10:30 – 11:00	Pushim letrar & kafe – Kujtesë autobiografike nga Alma Liço dhe Gjeto Vocaj
11:00 – 12:30	<p>Prezantime III: Projekte dhe Iniciativa për ish të Përndjekurit Moderatore: Jonila Godole, IDMC</p> <p>Bilal Kola, Drejtor i Institutit për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë, Tiranë Simon Mirakaj, Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politik Demokratë Arjeta Kokalari, Muzeu Musine Kokalari, Gjirokastrë Miran Butka, Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë Filip Guraziu, Nënkryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë, Shkodër Gëzim Peshkëpia, « Projekti i Spaçit»</p>
12:00 – 13:00	Diskutime dhe Konkluzione
<p>E enjte 27 Tetor, Telekom Albania Community (ish-Blloku) KONKURSI “PYET GJYSHËRIT” - CEREMONIA E SHPALLJES SË ÇMIMEVE</p>	
17:30 – 18:00	Regjistrimi
18:00 – 18:30	<p>Hapja nga Jonila Godole, drejtore e IDMC. Përshëndetje nga Walter Glos, Drejtor i KAS, Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Anke Holstein, Zëvendësambasadore e Gjermanisë dhe Nora Malaj, Zëvendësministre e Arsimit dhe Sporteve</p>
18:30 - 19:30	<p>Prezantimi i punëve më të mira të konkursit dhe vlerësimi i jurisë: Fatos Lubonja (Publicist, gazetar); Eno Popi (Moderator, TV Top Channel); Persida Asllani (Drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare); Eol Çashku (Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”); Zamir Kokonozi (Universiteti i Arteve).</p>
19:30	Koktej
<p>E premte 28 Tetor, Xheko Imperial (Carlsberg Hotel) HAPJA E DOSJEVE TË SIGURIMIT – SA MË PARË, AQ MË MIRË</p>	
9:00	Regjistrimi
9:30	<p>Fjalë përshëndetëse nga Walter Glos, Drejtor i KAS; Bernd Borchardt, Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri; Anke Holstein, Zëvendësambasadore e Gjermanisë</p>
9:40 – 10:30	<p>Fjalimet kryesore</p> <p>“Hapja e Dosjeve – Përmbushja e një Detyrimi” Hildigund Neubert, Zëvendëskryetare Bordi, Fondacioni Konrad Adenauer, ish-Komisionere për dosjet e STASI-it, Thüringen, Gjermani</p> <p>“Vonesat e procesit – Pasoja për të ardhmen” Edmond Spaho, Zëvendëskryetar i Parlamentit Shqiptar</p>

	<p>“Hapja e dosjeve të fshehta dhe ndikimi i tyre në ballafaqimin me të kaluarën komuniste” Luljeta Lleshanaku, Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit</p> <p>“E drejta për të vërtetën rreth komunizmit – rasti i Shqipërisë” Gentiana Sula, ish Zëvendësministre e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë</p>
10:30 - 11:00	Pushim / Kafe
11:00 - 11:30	<p>Paneli I: Viktimat e SIGURIMIT – Trauma psikologjike deri më sot Moderator: Adrian Kati, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për Traumën dhe Torturën</p> <p>Ariel Çomo, Psikiatër, Univeristeti i Tiranës Spitali Qendror Stefanie Knorr, Psikologe, Zyra e Këshillimit „Gegenwind“ për të traumatizuarit nga diktatura në Gjermaninë Lindore Fabian Kati, Antropolog & Regjisor</p>
11:30 - 12:00	<p>Paneli II: Aksesit në të shkuarën – Një mundësi për të mos u humbur Moderator: Ben Andoni, Gazetar</p> <p>Daut Gumeni, ish i përndjekur politik Valjeta Dosti Kaftalli, ish e përndjekur politike Thomas Raufeisen, ish i përndjekur politik, Gjermani</p>
12:00 – 12:30	<p>Prezantimi i ENCIKLOPEDIË Çelo Hoxha, nëndrejtor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri</p>
13:00	Drekë

PËRSHKRIM I SHKURTËR I AKTIVITETEVE

E hënë, 24 Tetor 2016, 18:00 - 19:00, Salla Antigonea, Hotel Rogner
Ceremonia e hapjes: TE KUJTOSH APO TË HARROSH TË SHKUARËN

Gjatë ceremonisë së hapjes së DITËVE TË KUJTESËS do të përshëndesin organizatorët e aktivitetit, Dr. Jonila Godole (IDMC) dhe z. Walter Glos (KAS), si dhe përfaqësues nga institucionet partnere: znj. Romana Vlahutin, Delegacioni i BE në Shqipëri, znj. Anke Holstein, Ambasada Gjermane si dhe Dr. Ulrich Mähler, Fondacioni Federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore, Berlin, i cili do të prezantojë ekspozitën “Lufta e Ftohtë: Shkaqet, Historiku, Pasojat” që do të jetë prezente dhe me akses të lirë gjatë Ditëve të Kujtesës.

Për mbi gjysëm shekulli Shqipëria ka qenë një vend tërësisht i izoluar ndërsa përjetonte një diktaturë të egër staliniste nën regjimin e Enver Hoxhës. Kjo është një arsye që ajo ka qenë pak ose aspak e njohur nga shoqëria perëndimore. Pas viteve 1990, Shqipëria dhe shqiptarët janë identifikuar më shumë me “mjeranët” e Europës, se sa me një komb europiandashës që nuk është thjesht një nocion gjeografik në kontinent. DITËT E KUJTESËS synojnë të nxjerrin nga izolimi atë pjesë të errët të historisë shqiptare, diktaturën enveriste, dhe ta bëjnë atë pjesë të kujtesës së përbashkët europiane. Kjo perspektivë do të prezantohet në fjalimin kryesor, mbajtur nga publicisti dhe studiuesi i njohur, Dr. Agron Gjekmarkaj dhe mban titullin: «**Perspektiva shqiptare si pjesë e kujtesës europiane**».

Shoqërimi muzikor i mbrëmjes do të bëhet nga **Gent Rushi Trio**
Gent Rushi, Accordion / Dritan Hekurani, Double Bass / Emiljani Dhimo, Drums

*

E hënë, 24 Tetor 2016, 18:45 - 19:00, Salla Antigonea, Hotel Rogner
“Fëmijët e Diktaturës”, dokumentar me regji nga Besnik Bisha (Universiteti i Arteve).

Dokumentari “Fëmijët e diktaturës” ka në qendër fatin e katër personave në moshë të ndryshme që lindën dhe kaluan fëmijërinë e tyre në burgje apo vendet e internimit. Ata i përkasin brezave të ndryshëm dhe sjellin për publikun shqiptar dhe të huaj një qasje autobiografike ndaj sistemit. Ky dokumentar, prodhim i IDMC në bashkëpunim me Universitetin e Arteve, Dega Regji, synon të rrisë ndërgjegjësimin kryesisht të brezit të ri mbi pasojat e diktaturës mbi jetën e individit, ku edhe foshnjat dënoheshin sipas ligjeve të kohës si “armiqtë e popullit”.

Ky film do të shfaqet gjatë vitit 2017 në institucione edukative dhe takime publike për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare mbi diktaturën. Dokumentari është i pajisur me titra Shqip dhe Anglisht. Çdo institucion i interesuar të shfaq dokumentarin në aktivite edukative mund të kontaktojë IDMC në office@idmc.al.

FJALIMI KRYESOR

Perspektiva Shqiptare si Pjesë e Kujtesës Europiane

Dr. Agron Gjekmarkaj, Universiteti i Tiranës

Monumentet kryesore të identitetit shqiptar Historia e Skënderbeut, Kanuni i Lek Dukagjinit, Këngët e Kreshnikëve, gjuha shqipe me fillesë Mesharin e Buzukut deri tek letërsia e Kadaresë janë pjesë e kujtesës Europiane sepse janë ngjizur bash nga lëvizja e pllakave tektonike të këtij identiteti. Duhet thënë që Europa ka bërë kronikanin e këtij vendi edhe kur dukej se lidhja me të ishte ndërprerë përgjithmonë. Figurativisht ato kronika shërbyen si spirancë që ndihmuan kthimin pas disa shekujsh!

... 45 vjet me radhë, konkretisht nga 1944 deri më 1990, shkrimi i kronikës u ndërpre. Izolimi, kloni, rojet vigjilente, nata mbi informacionin si dhe shndërrimi i çdo lajmi në propagandë janë lubrifikantë të totalitarizmit, sigurisht edhe të atij që përjetuam ne. Me mijëra vetë janë ekzekutuar me vdekje. Mijëra të tjerë janë burgosur deri në 40 vjet. Një numër i madh personash janë internuar, shpronësuar, privuar nga të drejtat, përdhunuar psikologjikisht dhe fizikisht. Një në tre veta thuhet se u rekrutua si bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit. Besimet u ndaluan dhe varfëria e uria rrafshuan sinoret e pabarazisë. Frika themeloi autocensurën dhe udhëhoqi arsyen aq sa ngjan se latinët dy shprehjet “homo homini lupus” dhe “canis canis homo”, sado e rëndë ta pohosh, ngjan t’i kenë bërë për ne.

... (por) historianët shqiptarë merren me retorikën e viteve 1944-1990, me Enver Hoxhën, në përpjekje për t’i gjetur anë pozitive, se një pjesë e tyre janë të indoktrinuar ideologjikisht. Hulumtimi i tyre mbi burgjet, torturat, ekzekutimet, vrasjet në kufi, grabitjet, përdhunimet, dosjet, hetuesitë, sigurimin e shtetit është inekzistent.

Ndaj sot është aq e madhe nevoja jonë që Europa t’i njohë, t’i çertifikojë, t’i pranojë e ruajë siç na ka ruajtur edhe të tjera gjëra ndër shekuj, se mbase fati na bën ndonjë shaka në yryshin që kemi marrë në estetizimin e kimit komunist, sa do nderojmë xhelatët dhe përbuzim heronjtë!

E martë, 25 Tetor 2016, 9:00 – 13:00, Salla Antigonea, Hotel Rogner
Konferenca ndërkombëtare: Ballafaqimi me të shkuarën - Historiografia, mësimdhënia dhe arsimimi

Konferenca ndërkombëtare mbi kurrikulën shkollore në vendet ish komuniste synon të mbledhë së bashku ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë që janë të angazhuar në fushën e kujtesës, të kurrikulës apo projekteve të tjera edukative.

21 ekspertë nga Shqipëria, Gjermania, Polonia, Rumania, Çekia, Lituania, Bosnja & Hercegovina, Kosova që do të shkëmbejnë me njëri-tjetrin dhe para një publiku të gjerë përvojën nga vendet e tyre në fushën e arsimit dhe sfidës për ndryshimin e kurrikulave pas rënies së Perdes së Hekurt. Konferenca do të ndiqet nga mësues historie, studentë, gazetarë dhe persona të interesuar për këtë temë.

Debati gjatë tre paneleve të konferencës do të ndiqet nga përfaqësues të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe do të shërbejë si një forum reflektues për përmirësimin e kurrikulës së shkollave shqiptare, një proces i pakryer siç duhet në këto 25 vite demokraci.

*

E martë, 25 Tetor 2016, 17:00 – 18:30, Salla Antigonea, Hotel Rogner
Brezi i ri kundrejt diktaturës shqiptare

Diskutimi në panel “Brezi i ri kundrejt diktaturës shqiptare” organizohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Radio Televizioni Shqiptar (RTSH). Ai synon të nxisë njohjen e së kaluarës totalitare të vendit nga ana e brezit të ri, si dhe debatin mbi të. Për këtë arsye diskutimi me Prof. Afrim Krasniqi dhe Prof. Nevila Nika me audiencën e re do të jetë interaktiv.

Debati do të regjistrohet nga RTSH dhe do të shfaqet gjatë muajit tetor.

E martë, 25 Tetor 2016, 15:00 – 16:30, Salla Antigonea, Hotel Rogner
Prezantimi i projekteve të shkollave

Në kuadër të DITËVE TË KUJTESËS, në periudhën janar – korrik 2016, IDMC mori kontakt me një sërë shkollash dhe mësues historie në gjithë vendin, për të mësuar nga afër shqetësimet dhe nevojat e tyre në lidhje me rritjen e interesit të nxënësve për këtë temë. Në kuadër të aktivitetit, do të prezantohen projektet fituese të shkollave nga gjithë vendi.

- 1) Projekti «**#throwback**», **Kolegji “New York” në Tiranë**, udhëhequr nga mësuese Anila Beshaj, me pjesëmarrjen e nxënësve: *Enis Lalmi, Erisa Ganellari, Grejdi Meta, Sara Kosturi*. Projekti konsiston në një ndërthurje midis imazhit grafik dhe videos. Tema e zgjedhur lidhet në mënyrë direkte me regjimin e kohës, duke pasqyruar me vërtetësi të gjitha anët e errëta të tij.
- 2) «**Kundër Besimit Katolik në Mirditë**», **Gjimnazi i Rrëshenit**, udhëhequr nga mësuese Marie Brozi. Tema është zgjedhur si e tillë, sepse katolicizmi në Mirditë është parë si pjesë e pandarë e jetës shoqërore, kulturore e arsimore. Projekti parqet humbjen e vlerave kishtare, muzeale, artistike e kulturore në Mirditë.
- 3) «**Vendet e Kujtesës – Burgu i Spaçit**», Viti I, Master, Departamenti i Historisë, udhëhequr nga Dr. Enriketa Papa. Studentët sjellin reflektimin e tyre mbi vizitën studimore organizuar nga IDMC më 18 Shkurt 2016, në ish-burgun e Spaçit.
- 4) «**Jeta e përditshme në regjimin komunist**», Gjimnazi Sami Frashëri, Tiranë, udhëhequr nga mësuese Elmira Gjonaj me pjesëmarrjen e nxënësve: *Kristiana Ndoi, Zhaklina Elezaj, Sonja Memaj, Livia Gjonaj, Aldi Hidi, Xhesilda Mehmeti, Andi Bozgo*. Projekti synon të njohë të rinjtë me realitetin e jetës së përditshme gjatë diktaturës dhe pasojat e saj, për të garantuar një të ardhme më të sigurt.
- 5) «**Kupto të shkuarën përmes fotografive familjare**», Gjimnazi Isa Boletini, Vorë, udhëhequr nga mësuese Vojsava Kumbulla dhe Renata Fetah me përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në projekt. Projekti synon të pasqyrojë fuqinë e propagandës komuniste për të maskuar fytyrën e vërtetë të tyre me qëllimin e vetëm adhurimin, përluljen, respektin ndaj liderit dhe pushtetit.
- 6) «**Kërkimi në gazetatat komuniste: Procese, rezultate dhe hapje dialogu**», drejtuar nga Prof. Lori Amy, OTTONomy, me pjesëmarrjen e studentëve nga Universiteti New York Tiranë dhe Departamenti i Gazetarisë.
- 7) «**Viktimat e diktaturës**», Gjimnazi Çajupi, Tiranë, udhëhequr nga mësuese Ina Kasimati. Projekti njeh të rinjtë me viktimat e diktaturës dhe dënimet e tyre.
- 8) «**Studimi: Sindroma e traumës post-komuniste**», nga Prof. Trudy Anderson. Studimi paraqet rezultatet e një ankete mbi qëndrimet e të rinjve ndaj periudhës komuniste dhe ndikueshmërinë e tyre nga ajo periudhë.

**E mërkurë 26 Tetor, 9:00 – 13:00, Salla
Tirana, Hotel Rogner
KUJTESA SI MISION – Prezantimi i institucioneve të kujtesës**

Cilat janë institucionet që merren me trajtimin e diktaturës në Shqipëri dhe rajon? Në cilat fusha punojnë ato? Cilat janë projektet konkrete që kanë ndërmarrë në vitet e fundit? Si mund të krijohet një rrjet më eficient bashkëpunimi mes tyre për t'i shërbyer kauzës së Kujtesës si mision? Këto dhe pyetje të tjera do të jenë në qendër të prezantimeve ditën e enjte. Takimi në kuadër të DITËVE TË KUJTESËS synon të shërbejë si një urë lidhëse mes aktorëve të interesuar në ndërgjegjësimin e rinisë dhe shoqërisë mbi shkaqet dhe pasojat e diktaturës në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet do të jenë institucionet:

Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë
 Instituti për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë, Tiranë
 Shoqata e ish të Përndjekurve Politik Demokratë, Tiranë
 Shoqata e ish të Përndjekurve Politikë, Shkodër
 “Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës”, Shkodër
 Instituti i Studimeve Politike, Tiranë
 Forumi i Shërbimit të Paqes Civile (ZFD), Prishtinë
 Instituti i studimeve shqiptare "Lumo Skëndo"
 Organizata “Drejtësi dhe Paqe”, Shkodër
 Muzeu Musine Kokalari, Gjirokastër
 Grupi organizator për “Projektin e Spaçit”
 Instituti për Demokraci, Media & Kulturë (IDMC)

*

**E mërkurë 26 Tetor, 10:30 – 11:00, Salla Tirana, Hotel Rogner
Lexime nga autobiografite e dëshmitarëve të kohës**

Aktorë të rinj do të lexojnë pjesë të shkurtra nga autobiografite e dy autorëve: **Alma Liço** dhe **Gjeto Vocaj**. Në librin "Krahë të Këputur", Alma Lico përshkruan kalvarin e saj të vuajtjeve në diktaturën komuniste. Ajo u internua së bashku me familjen e saj në moshën 10-vjeçare dhe u detyrua të jetojë në kushte të vështira mbijetese. Gjeto Vocaj flet në librin e tij "Takim fatal me diktatorin" për takimin me diktatorin Enver Hoxha dhe mënyrën si ndryshoi për keq jeta e tij si mësues në dekadat pasuese.

IDMC organizon vazhdimisht lexime të autorëve ish të përndjekur gjatë regjimit komunist me pjesëmarrje të brezit të ri. Kur shoqëria hesht për të shkuarën, kur mungojnë vendet muzeale që dokumentojnë krimet e diktaturës, letërsia autobiografike dhe kujtimet e dëshmitarëve të kohës mbeten të vetmet dëshmi të gjalla dhe shërbejnë si vende kujtese.



**E enjte 27 Tetor, 18:00 – 20:00, Telekom Community Store (ish-Blloku)
KONKURSI “PYET GJYSHËRIT” - CEREMONIA E ÇMIMEVE**

Konkursi me titull “PYET GJYSHËRIT” u shpall më 18 Maj 2016 për të rinj mbi 15 vjeç. Ai i ftoi ata të reflektonin përmes punimeve kreative në *Multimedia* për histori, përvoja dhe përjetime familjare gjatë diktaturës në Shqipëri. IDMC përmes këtij projekti synonte të mundësonte një shkëmbim dhe përballje midis brezave, një proces ky i munguar në dy dekadat e fundit. Edhe pse diktatura në Shqipëri ka qenë ndër më të ashprat në Evropën Juglindore, ende të rinjtë shqiptarë nuk e njohin periudhën e errët komuniste.



Përmes konkurseve kreative, IDMC synon të thyejë amnezinë shoqërore në lidhje me diktaturën, duke mbështetur dhe motivuar brezin e ri të bëjë pyetjet e munguara.

Konkursi “PYET GJYSHËRIT” është mbështetur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Më 2016 IDMC organizoi konkursin “Lindur në 90-ën: Zbulo të shkuarën, krijo të ardhmen”, i cili u mbyll me sukses më 22 Tetor 2015 me dhjetë fitues në 3 kategori: *ese dhe letërsi, multimedia dhe arte figurative*.

Këtë vit do të shpallen 6 fitues nga juria dhe 1 fitues nga publiku përmes klikimeve të punimeve të hedhura online në faqen zyrtare të IDMC në FaceBook.

Juria e këtij viti:

Fatos Lubonja (Publicist, gazetar);
Persida Asllani (Drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare);
Eol Çashku (Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”);
Eno Popi (Moderator, TV Top Channel);
Zamir Kokonozi (Universiteti i Arteve).

**E premte 28 Tetor, 9:00 – 13:00, Xheko Imperial (Carlsberg Hotel)
HAPJA E DOSJEVE TË SIGURIMIT – SA MË PARË, AQ MË MIRË**

Në Maj 2015, një çerek shekulli pas rënies së sistemit komunist, Shqipëria ka përfunduar debatin mbi meritën e hapjes së Dosjeve të Komunizmit. Por pas më shumë se një viti që Parlamenti i Shqipërisë miratoi hapjen e e dosjeve të shërbimit sekret në periudhën e komunizmit nuk ka asnjë shenjë të zbatimit të tij. Institucioni përgjegjës për zbatimin e tij nuk është krijuar ende.

Në këtë kontekst, aktiviteti që zhvillohet më 28 tetor në kuadër të DITËVE TË KUJTESËS ka për qëllim vetëdijësimin për implementimin e ligjit dhe për të ushtruar presionin e nevojshëm ndaj Parlamentit dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm. Dilemës se sa emergjente është hapja e dosjeve që shqiptarët të njihen me të shkuarën e tyre do t'i japin përgjigje ekspertë të njohur ndërkombëtarë, duke sjellë edhe eksperiencën e vendeve të tjera që e kanë kaluar tashmë këtë proces.



MEMORY LAYO

Institute for Democracy Media & Culture

Institut Châbrine për Krimin dhe Paqen e Komunitetit

Konrad Adenauer Stiftung

**HAPJA E DOSJEVE
TË SIGURIMIT**

SA MË PARË, AQ MË MIRË

28 TETOR 2016

EKSPOZITA SHOQËRUESE PËRGJATË DITËVE TË KUJTESËS 2016

24 – 26 Tetor, Salla Antigonea & Tirana, Rogner Hotel
Hyrje e lirë për publikun gjatë DITËVE TË KUJTESËS

Në kuadër të kësaj jave do të ketë tre ekspozita me akses të lirë për publikun e gjerë:



Ekspozita “Lufta e Ftohtë: Shkaqet, historia, pasojat” sjell momentet kryesore të marrëdhënieve Lindje-Perëndim gjatë viteve 1945 – 1991, pra, nga përfundimi i Luftës II Botërore deri në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. Ekspozita është një bashkëpunim i Kolegjit Berlinez “Lufta e Ftohtë” me Fondacionin Federal për Studimin e Krimeve të Diktaturës Komuniste në Gjermaninë Lindore. Ekspozita tregon me foto dhe fakte konfliktet mes shoqërive të përfshira gjatë Luftës së Ftohtë dhe pasojat e kësaj lufte deri më sot.

